



Njoftim

Postuar në : 26/10/2021



Në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është regjistruar çështja (JR) nr. 60/2021, datë 20.10.2021 që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Durim Hasa kundër vendimit nr. 399, datë 14.06.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Sot, në datën 26.10.2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit u hodh shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes.

Trupi gjykues i caktuar me short është i përbërë si më poshtë vijon:

Kryesuese: Natasha Mulaj

Relator: Ardian Hajdari

Anëtarë: Ina Rama, Rezarta Schuetz, Albana Shtylla

Informacioni është aksesuar në faqen zyrtare të KPA në linkun: <https://kpa.al/njoftim-628/>